

Informatat mbi Projektin

Emri i Projektit:	“Vetëdijësimi i qytetarëve mbi rëndësinë dhe përmbajtjen e MSA-së”
Vlera e projektit:	20,000 EUR
Kohëzgjatja:	14 muaj - 01/03/2018 - 30/04/2019
Organizata implementuese:	Internews Kosova
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	Menza e studentëve, kati i parë, 10000 Prishtinë, Kosovo; +381 38 22 44 98 dhe +377 44 96 98 54 http://internewskosova.org/
Grupet e synuara:	N/A.
Partnerët:	N/A
Territori i synuar/ shtrirja gjeografike:	Prishtinë, Kosovë.
Qëllimi i përgjithshëm:	Internews Kosova përmes projektit në fjalë, ka për qëllim vetëdijësimin dhe edukimin e qytetarëve të Kosovës mbi kushtet e caktuara në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, drejt procesit të integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian. Pra, Internews Kosova përmes kësaj iniciative synon të informojë publikun e gjerë mbi rëndësinë dhe përmbajtjen e temave në vijim: konkurrenca, të drejtat e pronësisë intelektuale, mbrojtja e konsumatorit, dhe migracioni legal.
Aktivitetet kryesore:	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja dhe publikimi i një PSA (Public Service Announcement)/ video promocale edukuese për qytetarët dhe bizneset për zbatimin e ligjit për konkurrencën. - Organizimi i një tryeze të rumbullakët ndër-institucionale në mes Autoritetit të Konkurrencës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe organizatave të shoqërisë civile me temë “Konkurrenca Fer”. - Organizimi i 4 diskutime live me institucionet përgjegjëse të linjës dhe palët e tjera të interesit siç janë bizneset. - Internews Kosova do të prodhojë dy debate/reportazhe në lidhje me kontrollin e cilësisë së ushqimit dhe mallërave në tregun e Kosovës. - Inicimi i një fushate (kampanje) për stimulimin e raportimeve nga qytetarët për rastet ata dyshojnë për fiksime të çmimeve, kur kemi produkte të falsifikuara apo kur kanë afat të skaduar, duke përfshirë këtu edhe raportimet për shqetësimet e qytetarëve (konsumatorëve) ndaj bizneseve keqpërdoruese. - Internews Kosova planifikon parashtrimin e ankesave nga zyra ligjore e KALLXO.com, tek agjencioni për mbrojtjen e konsumatorëve ndaj bizneseve keqpërdoruese. - Internews Kosova parasheh edhe përgatitjen e një hulumtimi për KALLXO.com, i cili do të reflektojë mbi cilësinë e produkteve ushqimore. - Internews Kosova do të organizojë 4 ligjërata me studentë të UP “Hasan Prishtina” dhe Kolegjit “AAB”, nga drejtimit e ekonomisë, gazetarisë, dhe juridikut.
Rezultatet e pritura:	<ul style="list-style-type: none"> - Internews Kosova parasheh një ngritje të nivelit të njohurive mbi çështjen në fjalë tek të rinjtë e vendit, bizneset lokale dhe konsumatorët, si dhe institucionet partnere gjatë zbatimit të projektit. - Si rezultat përfituesit e projektit apo grupet e targetuara, pritet të jenë të informuar më detajisht në lidhje me përfitimet që i sjell MSA-ja për shtetin tonë; konsumatorët do të jenë në gjendje të identifikojnë paraprakisht tendencat e bizneseve të cilat kanë për qëllim keqpërdorimin dhe manipulimin e produkteve të tyre; poashtu, studentëve të targetuar do t’u ngritet diapazoni i njohurive mbi temat e shtjelluara në projekt, dhe veçanërisht mbi të drejtën e autorit në kuadër të pronësisë intelektuale. - Internews Kosova planifikon të influencojë mbi kontrollin korrekte dhe adekuate të cilësisë së produkteve nga institucionet relevante.

Përkrahur nga: